



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 56, datë 18.09.2020

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	UNIVERSITETI I MJEKËSISË
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☐ • Reklamim nga të tretë ☒
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë prokurimi me vlerë të vogël
Konstatimet kryesore	Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhur me vendosjen e kriterëve të paargumentuara në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.
Masat e marra	Në bazë të neneve 13, pika 2/i, 66 dhe 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, APP vendosi t’i propozojë titullarit të Autoritetit Kontraktor, marrjen e masës disiplinore ndaj 3 (tre) anëtarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.